



553  
18.03.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1893 / Prot.

Tiranë, më 13.03. 2024

URDHËR

Nr. 101, datë 13.03. 2024

PËR

PROCESIN ZGJEDHOR PËR AUTORITETET DHE ORGANET  
DREJTUESE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjave "b" dhe "j" të nenit 7 dhe të nenit 131 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në datën 21.05.2024.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë data 21.06.2024.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë të marrin masat që të miratojnë rregulloren e zgjedhjeve, 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së fillimit të procesit zgjedhor, të cilat duhet të depozitohen pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Vendimet për rezultatet e zgjedhjeve të Komisioneve Institucionale Zgjedhore të institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqiten në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit sipas afateve ligjore, ndërsa propozimi i MAS për dekretimin e Rektorëve nga Presidenti i Republikës, do të paraqitet sipas afateve ligjore pa cenuar mandatin e Rektorëve në detyrë.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

